

VENDIM
Nr. 40, datë 6.10.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, me:
Drejtues ligjor : Redi Molla;
Drejtues teknik : Ortion Dhami, Edgar Çani.
2. Operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria B: Për përpunimin e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Tiranë,
Kamzë (pjesërisht), Vorë (pjesë-risht).
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare (njëvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani